

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kuvendi injoron konsultimet, nxiton dhe fut në shqyrtim Reformën Territoriale
ADRESA	https://lapsi.al/kuvendi-injoron-konsultimet-nxiton-dhe-fut-ne-shqyrtim-reformen-territoriale-i1094308
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:53:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 15:04:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ff411a5f957969a9b83ab6d33ca611fb6eedc5587e1b2a052e9aee1fd1bdc69f
TEKSTI	cb888f5e88c180b95408280d7bdc30c7ef7197c15b41fab0c9b80ca9c98492e0
PAMJA	a58e187fb29aa38ca375075d2a33d76bb18c91a46a7dbead930b3e66738ba984

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	becf116d8ec857880ba22887915cf91498db4288eca525601471a42144809877
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/becf116d8ec857880ba22887915cf91498db4288eca525601471a42144809877>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kuvendi injoron konsultimet, nxiton dhe fut në shqyrtim Reformën Territoriale

LAPS1.AL • 23 SEPTEMBER 2026



Nisma e PS-së për reformën territoriale u fut në kalendarin e punës së Kuvendit pa pritur përfundimin e konsultimeve publike me komunitetet dhe këshillat bashkiakë, ndërsa opozita e kundërshtoi si një akt që bie ndesh me Kushtetutën.

Komisioni për Çështjet Ligjore mori në shqyrtim të mërkurën projektligjin "Për ndarjen administrativo -territoriale të njërive të qeverisjes vendore" të propozuar nga deputetët socialistë, ndërsa konsultimet publike me komunitetet lokale vijojnë deri në fund të shtatorit.

Ulsi Manja, kryetar i këtij komisioni, refuzoi të hidhte në votim kërkesën e opozitës për të rikthyer procedurën e shqyrtimit dhe depozitimin e nismës me përfshirjen e qëndrimeve që vijnë nga komunitetet lokale.

"Ne do të vijojmë shqyrtimin në parim deri më 29 shtator, kur është afati i përfundimit të konsultimeve nëpër bashki, pastaj pasi të marrim dhe këto qëndrime, e votojmë," tha ai.

Sipas një kalendari pune të Kuvendit, ku parashikohet votimi në seancë plenare më 8 tetor, socialistët në mënyrë të njëanshme kanë vendosur të avancojnë përpara procedurën parlamentare të nismës, ku propozohet një rikonfigurim i hartës territoriale të vendit me reduktimin e bashkive nga 61 në 46.

Opozita kundërshtoi në komision futjen në rend dite të nismës së PS-së, duke pretenduar se nisma ishte dorëzuar në shkelje të dispozitave ligjore dhe kushtetuese duke anashkaluar përfundimin e konsultimeve publike.

"Të kthehet pas dhe të futet në procedurën kushtetuese se s'mund të ecim në shkelje të Kushtetutës," tha Luçiano Boçi, i cili ishte bashkëkryetar i opozitës për komisionin

ide



Rënia e Vlorës në shtratin e krimit
Armand Shkullaku



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes manizmi
Andi Bushati

MOTITIRANA

21°C

KËMBIMIEURO

91.46

aktuale

98:28

Afro katër muaj në shesh, qytetarët nuk tërhiqen: Kërkojnë largimin e Ramës

21:41



Dita e 115-të e protestës/ Nuk mungojnë mesazhet e Vlorë Hysenit



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



bipartizan për këtë reformë.

“Të mbarojnë dëgjesat, të merret mendimi dhe më pas të vihet këtu,” shtoi ai, duke këmbëngulur se një reformë e njënashme pa konsensus politik dhe për më tepër pa konsensus qytetar bie ndesh me parashikimet kushtetuese.

Edhe deputeti Oerd Bylykbashi kërkoi që Komisioni i Ligjeve të votonte për kthimin e projektligjit në zyrën e Kryetarit të Kuvendit për t’u përfshirë në nismë edhe qëndrimet e konsultimeve publike.

“Kjo nismë godet themelet e Kushtetutës dhe është detyrim ligjor që të merren parasysh qëndrimi i popullsisë,” tha Bylykbashi, duke akuzuar mazhorancën se ka nisur procedurën në shkelje ligjore dhe se po tenton të anashkalojë qëndrimet e komuniteteve.

Deputetë të tjerë të PD-së sollën në vëmendje që në bashkitë që projekti i PS-së parashikon t’i shkrijë me bashki më të mëdha po bëhen protesta të përditshme kundër nismës dhe vetë këshillat bashkiakë kanë votuar kundër shkrirjes.

Në shenjë revolte, deputetët e opozitës braktisën mbledhjen e komisionit, e cila vijoi me prezantimin e nismës nga Arbjan Mazniku.

Mazniku tha se reduktimi i numrit të bashkive do të siguronte më shumë shërbime për qytetarët.

Që prej fillimit të gushtit në të gjitha bashkitë e vendit, propozimi i PS-së po has kundërshti nga qytetarët gjatë dëgjesave publike. Në disa bashki të vogla ka shkaktuar edhe protesta të përditshme që refuzojnë shkrirjen e njësisë së tyre vendore me një njësi më të madhe.

Sipas projektit, bashkitë Fushë-Arrëz, Klos, Rrogozhinë, Dimal, Poliçan, Patos, Divjakë, Selenicë, Maliq, Këlcyrë, Memaliaj, Libohovë, Cërrik, Belsh dhe Prrenjas humbasin statusin si njësi të pavarura të vetëqeverisjes vendore dhe bashkohen me bashkitë fqinje më të mëdha.

Konkretisht, Fushë-Arrëzi bashkohet me Pukën, Klosi me Matin, Rrogozhina me Kavajën, Dimali dhe Poliçani me Beratin, Patosi me Fierin, Divjaka me Lushnjën, Selenica me Vlorën, Maliqi me Korçën, Këlcyra me Përmetin, Memaliaj me Tepelenën, Libohova me Gjirokastrën, Cërriku e Belshi me Elbasanin, ndërsa Prrenjasi kalon nën varësi të bashkisë Librazhd.

Modeli i propozuar synon të ruajë bashkinë si qendrën e organizimit vendor, por ndryshon organizimin e saj të brendshëm nga skema “Bashki–Njësi Administrative” në “Bashki–Qytet–Njësi Administrative”.

Për çdo qytet parashikohet emërimi i një nënkryetari përgjegjës për koordinimin e shërbimeve, ndërsa këshillat bashkiakë do të riorganizohen për të pasqyruar peshën demografike të qyteteve përbërëse.

Nga ana tjetër opozita ka dalë me një projekt që propozon shtimin e bashkive nga 61 në 100 njësi për të decentralizuar shërbimet publike më pranë komuniteteve./ BIRN



Video që tregon se Rama e dinte paraprakisht për Vlora Hysenin



Arrestohet në Morinë shefja e SHISH, Vlora Hyseni



Ambasada amerikane mesazh për sigurinë, pasi u shpall në kërkim drejtuesja e SHISH



SPAK reagon zyrtarisht për "arrestin" e shesës së SHISH

Të këshilluara



Kthesa ekonomike? Çmimet e apartamenteve humbin vrullin në 2026

Rritja e çmimeve të banesave u frenua në gjysmën e parë të këtij viti. Sipas informacionit nga Banka e Shqipërisë...



GJKKO urdhëron SPAK kryejë hetime mbi pretendimet e banorëve të Rrjollit

Pas vendimit të SPAK-ut për mosfillimin e hetimeve lidhur me kallëzimin e banorëve të Rrjollit për falsifikim dokumentesh dhe kor...



Kërcënoi me thikë 50-vjeçaren gjermane te Liqeni Artificial dhe i grabiti çantën, arrestohet 41-vjeçari në Tiranë



Përgjimet ekskluzive/ "O shpirt", "o zemër". Vlorë, një spiune që pasioni e çoi drejt krimit

Dalin bisedat me ngjyrë rozë të kryespiunes me Ergys Agasin gjatë muajve të verës kur ai gjendej në arrati



Zbulohet kush e zëvendëson Vlorë Hysenin në krye të SHISH


Elvis Lila ka marrë përkohësisht kompetencat e drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit, pasi shkarkimit të Vlorë Hyseni...



Mesazhet me shefen e SHISH/ Gys Agasi i mbajti shpresat te Edi Rama deri në fund

Mesazhet në telefonin e Ergys Agasit tregojnë se shpresa e vetme që i mbeti në ditët e fundit të arratisë ishte se Edi Rama ...





Berisha: Rama po përpiket ta paraqesë si aferë dashurie, por Vlorë Hyseni e ka marrë çdo vendim me porosi të tij



Zbardhen komunikimet kompromentuese, Vlorë Hyseni i raportonte Ergys Agasi axhendën dhe takimet me Ramën

Komunikimet e zbuluara mes ish-drejtuës së Shërbimit Informativ Shtetëror, Vlorë Hyseni, dhe Ergys Agasi zbulojnë një tërë...



Prokuroria e Posaçme zbuloi 9 faqe me të dhëna sekrete të SHISH në makinën e Agasi, biznesmeni: I lash me qëllim që t'i gjente SPAK

Detaje të reja janë zbardhur pas arrestimit të drejtueses së SHISH, Vlorë Hyseni, ndaj së cilës SPAK caktoi masën e sigurisë...



"Do përfundojmë keq, shpirt..." Dalin përgjimet e Gys Agasi me Vlorë Hysenin

Po dalin në media mesazhet mes Vlorë Hysenit dhe Ergys Agasi, për të cilat SPAK thotë se kanë natyrë të ndryshme nga...

Me sytë katër



21:27

PAMJET/ 6-vjeçarja kineze vë rekord botëror për zgjidhjen e Kubit të Rubikut

Një rekord botëror i pabesueshëm - dhe jo një herë, por dy herë - u thye brenda 3 ditësh nga 6-vjeçarja Lian Yunji ng...



PAMJET/ Nis papritur bora në bjeshkët e Deçanit

20:52



Dy VIDEO-t/ Si e paralajmëroi Gaz Bardhi lidhjen Gys Agasi-Vlorë Hyseni

16:12



ERRALLE/ Trump del në TV pa zë për shkak të bojkotit të mediave

22:10



Berisha nxjerr VIDEON/ Pjerin Ndreu u përplas me shqiptarët e takimit të Ramës në Michigan

21:02

SPORT

→ Të tjerë artikuj





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.